



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA GRAMSH**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**Njoftim per konsultim publik**

**Këshilli i Bashkisë Gramsh**

**Titulli:** Mbledhja e rekomandimeve per prioritetet e komunitetit per tavanet perfundimtare buxhetore te projekt buxhetit afatmesem 2027 – 2029.

**Propozuesi:** Projekt aktet jane propozuar nga Ekzekutivi/Kryetari i Bashkise, Z. Besion Ajazi

**Sqarime për projekt aktin:** *Nevojat e komunitetit për përmirësimin e shërbimeve publike bazuar në programin buxhetor afatmesem 2027-2029*

**Kalendari i konsultimit:** Konsultimi publik do te realizohet në datat si më poshtë:

Nr	Aktiviteti	Data	Vendi	Ora	Mënyra	Forma
1	Konsultim publik me banorë, biznese, OJF, mësues, grupe vulnerabel, etj, ne qytetin <b>Gramsh</b>	20/04/2026	Gramsh	11:00	Takim publik	Bisedë
2	Konsultim publik me banorë, Kryetare Fshatrash, mësues, etj te Njesisë Administrative <b>Kodovjat</b>	27/04/2026	NjësiaAdm Kodovjat	11:00	Takim publik	Bisedë
3	Konsultim me banorët e Njesise Administrative <b>Kukur</b> , Kryetare Fshatrash, mesues, grupe vulnerable etj.	27/04/2026	Njësia Adm Kukur	13:00	Takim publik	Bisedë
4	Konsultim me banorët e Njesise Administrative <b>Kushove</b> , Kryetare Fshatrash, mesues, grupe vulnerable etj.	30/04/2026	Njësia Adm Kushove	13:00	Takim publik	Bisedë
5	Konsultim me banorët e Njesise Administrative <b>Lenije</b> , Kryetare Fshatrash, mesues, grupe vulnerable etj.	04/05/2026	Njësia Adm Lenije	11:00	Takim publik	Bisedë
6	Konsultim me banorët e Njesise Administrative <b>Pishaj</b> , Kryetare Fshatrash, mesues, grupe vulnerable etj.	13/05/2026	Njësia Adm Pishaj	10:00	Takim publik	Bisedë
7	Konsultim me banorët e Njesise Administrative <b>Poroçan</b> , Kryetare Fshatrash, mesues, grupe vulnerable etj.	06/05/2026	Njësia Adm Poroçan	11:00	Takim publik	Bisedë
8	Konsultim me banorët e Njesise Administrative <b>Skenderbegas</b> , Kryetare Fshatrash, mesues, grupe vulnerable etj.	30/04/2026	Njësia Adm Skenderbegas	10:00	Takim publik	Bisedë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA GRAMSH**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

9	Konsultim me banorët e Njesise Administrative <b>Sult</b> , Kryetare Fshatrash, mesues, grupe vulnerable etj.	08/05/2026	Njësia Adm Sult	11:00	Takim publik	Bisedë
10	Konsultim me banorët e Njesise Administrative <b>Tunje</b> , Kryetare Fshatrash, mesues, grupe vulnerable etj.	11/05/2026	Njësia Adm Tunje	11:00	Takim publik	Bisedë
11	Degjese publike me organizatat jo fitimprurese (OjF) lokale	13/05/2026	Gramsh	13:00	Takim publik	Bisede

**Banorët do të kenë mundësi të konsultojnë dokumentat në lidhje me çështjet për diskutim në dokumentat perkatese te publikuara ne faqen e internetit te Bashkise Gramsh:**

<https://bashkiagramsh.gov.al/>

**Pjesëmarrës:**

- **Nga ana e Bashkisë dhe e këshillit bashkiak:** Anëtarët e Keshillit Bashkiak, Përfaqësues nga ekzekutivi , Anëtarët e Komisionit te Ekonomisë dhe Financës të Këshillit të Bashkisë, Kryetarja e Aleancës së Grave Këshilltare, Koordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin Publik, drejtorja e Financës/Buxhetit të Bashkisë,
- **Nga komuniteti:** Banorët e qytetit të Gramshit, banorë dhe përfaqësues nga NJA, kryetarët e fshatrave, përfaqësues nga institucionet, përfaqësues nga biznesi, përfaqësues nga grupe të marginalizuara, OJF, etj
- **Forma e konsultimit:** Takim publik

Qëllimi i këshillimit publik	1. Evidentimi i nevojave te komunitetit per permiresimin e sherbimevepublike bazuar ne buxhetin e 2027-2029
Përshkrimi i çështjeve që trajton projekt buxheti afatmesëm	Miratimi i projekt buxhetit afatmesëm është një vendim i rëndësishëm që merret nga Këshilli i Bashkisë, pasi përcakton fondet që do të përdoren për të gjitha shërbimet / funksionet e ushtruara nga Bashkia dhe performancën e tyre. Këshilli i Bashkisë duhet të sigurohet që fondet publike shkojnë për përmirësimin e shërbimeve që ofrohen nga Bashkia për komunitetin dhe adresojnë nevojat e tyre, brenda kapaciteteve financuese të Bashkisë. Për këtë, Këshilli i Bashkisë do të organizojë këtë konsultim publik për të marrë mendimin dhe sugjerimet e qytetarëve për mënyrën se si janë përdorur fondet gjatë vitit 2025, nivelin e arritjes së objektivave të shërbimeve, si dhe listën me shërbime / funksioneve nga e



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA GRAMSH  
KËSHILLI BASHKIAK

	<p>cila komuniteti përzgjedh ato shërbime për të cilat mendon se bashkia duhet të shpenzojë më shumë gjatë tre viteve të ardhshme.</p>
<p>Pyetjet që ngre Këshilli ndaj publikut</p>	<p>Këshilli i Bashkisë është i interesuar të marrë opinionin e komunitetit në lidhje me çështjet si vijon :</p> <ol style="list-style-type: none"><li>1. A jeni dakort me mënyrën si janë shpenzuar paratë?</li><li>2. Cilat jane nevojat tuaja per te cilat duhen permiresuar sherbimet nga ana e Bashkise?</li><li>3. Cilat janë shërbimet prioritare për të cilat bashkia duhet të shpenzojë më shumë fonde publike gjatë periudhës 2027 – 2029?</li><li>4. Për cilin shërbim publik jeni më të kënaqur?</li><li>5. Tjetër</li></ol>
<p>Shpjegim të procesit që do ndjekë dhe veprimet që do të ndërmerret Këshilli për të shqyrtuar rekomandimet nga publiku deri në marrjen e vendimit</p>	<p>Pas mbledhjes së rekomandimeve, Këshilli i Bashkisë do të ndjekë hapat si vijon:</p> <ol style="list-style-type: none"><li>1. Realizimin nga ana e Sekretariatit të Këshillit i një Përmbledhje të Rekomandimeve dhe rezultateve të plota të takimit që përfshin të gjitha mendimet dhe propozimet që do të vijnë nga komuniteti dhe bërja publike e kësaj Përmbledhje;</li><li>2. Dërgimi i kësaj Përmbledhje Rekomandimesh Kryetarit të Bashkisë, Komisionit të Ekonomisë dhe Financës, taksave dhe tarifave dhe çdo këshilltari të bashkisë;</li><li>3. Shqyrtimi nga ana e komisionit të ekonomisë dhe financës, taksave dhe tarifave (<b>mbledhja e komisionit është e hapur për publikun sipas datave të parashikuara në kalendar</b>) të cdo rekomandimi dhe të opinionit të Kryetarit të Bashkisë;</li><li>4. Marrja e vendimit për rekomandimet që do të përfshihen në projekt buxhetin afatmesëm dhe projekt buxhetin vjetor. Vendimi i bashkëngjitet dokumentit të projekt buxhetit afatmesëm dhe projekt buxhetit vjetor;</li><li>5. Diskutimi dhe miratimi i aktit në <b>seancën e hapur</b> të Mbledhjes së Këshillit;</li><li>6. <b>Informimi i komunitetit</b>, për marrjen në konsideratë të rekomandimeve ose për mosmarrjen në konsideratë dhe arsyet e mosmarrjes në konsideratë të tyre;</li></ol>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA GRAMSH**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

	<p>7. <b>Publikimi</b> i aktit në faqen e Këshillit të Bashkisë dhe në tabelat e informimit;</p> <p>8. <b>Njoftimi</b> i administratës për aktin e miratuar;</p> <p>9. <b>Monitorimi</b> i zbatimit të tij.</p>
Ndryshimet kryesore dhe/ose alternativat e mundshme	Opsionet e mundshme janë për t'u shqyrtuar nga ana e Këshillit tone : Ndryshime në alokimin e fondeve për programe të caktuara me qëllim përmirësimin e shërbimeve të ofruara nga Bashkia.
Kontaktet dhe afatet e degimit te komenteve, rekomandimeve, verejtjeve	Sugjerimet janë të mirëpritura deri më datë 28 Maj 2026, në adresen e email: <a href="mailto:xhulia.gjini@hotmail.com">xhulia.gjini@hotmail.com</a>
Data e publikimit	09.04.2026